



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:278926
Datë: 11.12.2024
Numri i dokumentit: 06581031

Pml.nr.756/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit K. T., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 275 par. 1 nën-par. 1.9 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPRKR.nr.319/2023, të datës 04.11.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1137/2024 të datës 12.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit K. T., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PPRKR.nr.319/2023 të datës 04.11.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1137/2024 të datës 12.11.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.319/2023, të datës 04.11.2024, të pandehurit K. T. për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje (me të pandehurit A. M. dhe A. T.), ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 275 par. 1 nën-par. 1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t'i llogaritet nga data 05.11.2024 e deri me datën 04.01.2025. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184 par. 1 nën-par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.1137/2024 të datës 12.11.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesë e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit K. T., avokat Hamdi Jashari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 të KPP dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të lirohet për t'u mbrojtur në liri ose ndaj tij të shqiptohet ndonjë masë më e butë alternative apo lënda të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.319/2024 e datës 06.12.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se aktvendimet për vazhdimin e paraburgimit përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 të KPP, ngase dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta, kontradiktore dhe në nivelin e supozimeve. I pandehuri ka premtuar se do të jetë bashkëpunues me organet e drejtësisë dhe do t'i përgjigjet çdo ftese të bërë nga këto institucione. Nuk ekziston mundësia e ndikimit në dëshmitarë apo dëmtimin e provave, dhe se edhe me masa tjera mund të arrihej qëllimi i zbatimit

të suksesshëm të procedurës penale. Gjykata duhet të ketë parasysh mungesën e elementeve që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe rrethanat nën të cilat dyshohet se është kryer vepra penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit 2023-XI-DKKO-HTN-NJHHK-19 i datës 13.12.2023, aktvendimit për fillimin e hetimeve, procesverbalet e marrjes në pyetje të të dyshuarve, procesverbalet e identifikimit të të dyshuarve, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve si dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprat penale për të cilat pandehet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se i pandehuri pas kryerjes së veprës penale është arratisur dhe ka qenë i pa qasshëm për organet e drejtësisë nga data 12.12.2023 e deri më datën 06.10.2024, kur nga zyrtarët kompetent është arrestuar sipas urdhër arrestit të lëshuar nga gjykata.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i ndikimit në të bashkë të pandehurit te njëri tjetri që t'i koordinojnë deklaratat me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat, sasinë e substancës narkotike të llojit marihuanë në peshë prej katër (4) kg, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprat penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit lidhur me mungesën e elementeve që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe rrethanat nën të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, kjo Gjykatë gjen se rasti është në fazën e hetimeve dhe pritët që në fazat e ardhme të qartësohet dhe specifikohen të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me rastin dhe të pandehurin konkret.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa mbrojtja në liri, sipas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit nuk është masë adekuate për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.756/2024, më datën 09.12.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi